



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 22
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 25 nëntor 2015, në orën 10:30

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Njomza Emini dhe Adem Hoxha.

Munguan: Shukrije Bytyçi, Besa Baftiu dhe Time Kadrijaj.

Të ftuar: Imet Rrahmani- Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë, Curr Gjocaj – Drejtor i SHSKUK, Sadik Llullaku – Bordi i SHSKUK, Myzafë Kalinderi –Drejtor financiar – SHSKUK, Gani Shabanaj – Sekretar i Ministrisë së Shëndetësisë, Ramadan Halimi –Këshilltarë të ministrit: Musa Rexhaj e Arsim Qavderbasha, si dhe Mentor Sadiku, drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 18.11.2015;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani - Temë diskutimi:
 - Buxheti i shëndetësisë për vitin 2016,
 - Raporti i progresit për vitin 2015, pjesa për shëndetësi;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 18.11.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, më 18.10.2015, pa vërejtje.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani. Temë diskutimi:

- **Buxheti i shëndetësisë për vitin 2016,**
- **Raporti i progresit për vitin 2015, pjesa për shëndetësi.**

Kryetarja përshëndeti ministrin dhe përfaqësuesit e ministrisë, si dhe përfaqësuesit e SHSKUK- së. Sot në rend të ditës kemi një çështje të rëndësishme, buxhetin e shëndetësisë për vitin 2016 dhe më vjen keq që deputetët e opozitës nuk po marrin pjesë. Shëndetësia ishte një nga prioritetet e Qeverisë, por si po shihet nga buxheti i ndarë për vitin 2015, shëndetësia nuk është prioritet. Ka disa strategji dhe disa synime për reformë, por nuk janë të mbuluara me buxhet. Edhe Raporti i progresit pasqyron kritika për Ministrinë e Shëndetësisë se nuk po ju siguron shërbime shëndetësore adekuate qytetarëve të vet.

Nga ju kërkojmë të na njoftoni se përse Komisioni nuk konsultohet gjatë përgatitjes së buxhetit, sepse me përvojën tonë do t'ju kishim ndihmuar në përgatitjen e një buxheti më të saktë për arritjen e synimeve dhe objektivave shëndetësore.

Ligjet themelore, si është Ligji i shëndetësisë dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, nuk mund të zbatohen, sepse nuk është paraparë buxhet për themelimin e fondit dhe zbatim të këtyre ligjeve, e sidomos nuk është paraparë buxhet i mjaftueshëm për funksionalizim të SISH-it.

Ju kaloj fjalën që të na informoni për buxhetin, e pastaj deputetët do të parashtrajnë edhe pyetje shtesë.

Imet Rrahmani: Ju falënderoj për ftesën dhe jemi sot këtu që të bashkëbisedojmë me ju për të gjitha çështjet që lidhen me Ministrinë e Shëndetësisë, e sidomos për çështjen e buxhetit për vitin 2016, dhe për Raportin e progresit. Natyrisht edhe ne nuk jemi të kënaqur me buxhetin e ndarë për vitin 2016, por jemi munduar që brenda këtij buxheti të arrijmë maksimumin e asaj që mund të arrihet. Kemi pasur bashkëpunim të mirë me zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Financave dhe jemi munduar me i mirëkuptuar sfidat nëpër të cilat po kalon Qeveria. Ne i kemi respektuar kufijtë buxhetor të cilët Ministria e Financave na i ka përcaktuar dhe mbi bazën e këtyre kufijve kemi planifikuar një buxhet, i cili është i ndarë në dy organizata buxhetore, duke përfshirë edhe parësorin. Ky buxhet për këtë vit është 177 623 092 euro, prej të cilave në kujdesin parësor janë 5127539 euro, ndërsa në SHSKUK janë 87 892 641 euro, ndërsa në Ministrinë e Shëndetësisë janë 3 762 912 euro. Vështirësi të veçantë kemi pasur me akomodimin e projektit të Bankës Botërore brenda buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë, sepse këtë projekt duhet ta akomodojmë brenda buxhetit, e më vonë të bëhet rimbursimi me realizimin e projektit, pra ky projekt na ka dëmtuar për 4 359 254 euro. Në funksion të realizimit të mëtejshëm të reformës së filluar, dhe me qëllim të përmasimit të kapaciteteve ju kemi drejtuar me një kërkesë për numër shtesë të punëtorëve shëndetësorë, prej 54 punëtorësh. Shpresoj se do të na përkrahni në këtë kërkesë. Funksionalizimi i Odave, i SISH-it, i AFSH, fuqizimi i Inspektoratit Shëndetësor, funksionalizimi i Kardiokirurgjisë dhe i Kardiologjisë Invazive, janë prioritetet që Ministria e Shëndetësisë i ka trajtuar me prioritet dhe të njëjtat konsiderohen edhe prioritetet për vitin në vijim. E konsideroj si të domosdoshme shtimin e numrit të punëtorëve, si kusht për funksionalizimin dhe arritjen e objektivave të cekura më lart.

Për funksionalizim të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është e domosdoshme që për vitin 2016 të shtohet numri i të punësuarve për 26 punëtorë të AFSH- së. Me marrjen e mandatit nuk ka qenë e aprovuar as rregullorja për funksionalizimin e AFSH- së. Rregulloren e kemi miratuar në koordinim

me qeverinë, por kjo nuk është përcjellë edhe me numrin e caktuar të punëtorëve, por për vitin 2016, janë lejuar t'i kemi 12 vende shtesë, por me rregullore është parapa të jenë 50 punëtorë. Çështje tjetër është mos figurimi në buxhetin e vitit 2016, buxheti për sigurime shëndetësore. Ne jemi dakorduar me Ministrin e Financave që në momentin kur Ministria e Shëndetësisë është e gatshme të fillojë me mbledhjen e premieeve, atëherë do të ndahet buxheti i nevojshëm nga qeveria.

Kemi punuar mjaft shumë në dokumente operative të nevojshme për funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, kemi miratuar udhëzimin administrativ, kemi hartuar listën e çmimeve brenda spitalore dhe jashtë spitalore. E kemi inkorporuar brenda SISH-it sistemin e informimit të fondit. Fillimi i mbledhjes së premieeve nënkupton që ne të krijojmë parakushte të vazhdojmë tutje në kontraktimin e shërbimeve dhe fillimin e sigurimeve shëndetësore.

Ligji për odat ka paraparë angazhimin e 20 të punësuarve, pra atyre duhet t'ju sigurohen pagat dhe kushtet e tjera për punë, e këto ne nuk i kemi të përcjella me buxhet.

Te odat ka përparim të madh, jemi në përfundim të themelimit të odave, kemi ndarë hapësirat e nevojshme për punë dhe duhet të sigurohet edhe stafi mbështetës.

Në Inspektoratin shëndetësor kemi nevojë edhe për 50 inspektorë, por në këtë fazë kemi kërkuar 10 vende të reja dhe shpresoj të kemi përkrahjen tuaj. Ministria e Shëndetësisë ka nevojë gjithsej për 137 vende pune shtesë.

Buxheti i paraparë për barna për vitin 2016 është 21 970 884 euro, dhe nga raportet dhe planifikimet shihet se me këto mjete do të përmbushen nevojat vetëm për 9 muaj të vitit në vijim. Nga këto 15 180 897 janë të dedikuara për SHSKUK, ndërsa 6 789 987 euro janë në kujdesin parësor. Për mbulim të të gjitha nevojave për SHSKUK nevojiten edhe diku rreth 5 milionë euro.

Buxheti i ndarë për trajtim jashtë vendit është 6 milionë euro, por nuk është i mjaftueshëm. Kërkesat të cilat i ka aprovuar komisioni dhe të cilat ende nuk janë paguar na fusin në borxhe për rreth 1 milion euro, ndërsa për t'u realizuar të gjitha nevojat që dalin nga kërkesat e qytetarëve për trajtim jashtë vendit nevojiten rreth 9 milionë euro.

Me kërkesë dhe rekomandim të donatorëve, kemi kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe shpresojmë edhe në përkrahjen tuaj, që buxheti i ndarë për barna për SHSKUK dhe buxheti për projektin për ndërtimin e Spitalit të Ferizajt të kalojnë në menaxhim në Agjencinë e Financimit Shëndetësor.

Ju faleminderit për mirëkuptim dhe përkrahje.

Fikrim Damka: Kam disa pyetje për ministrin, por fillimisht sa i përket buxhetit për vitin 2016 mendoj se është një buxhet i pa mjaftueshëm për realizimin e reformës së sistemit shëndetësor.

Rreth 7 milionë euro janë shfrytëzuar për trajtim jashtë vendit, a keni ndonjë plan si të ndryshohet gjendja, për të kontraktuar ndonjë spital për kryerje të shërbimeve, sepse si e dimë qytetarët që kërkojnë trajtim jashtë vendit sjellin vetëm profakturën.

Gjithashtu kërkoni prapë që blerja e barnave të kalojë në menaxhim të AFSH-së, a keni ndonjë analizë se a ka përmirësim apo keqësim të gjendjes së furnizimit me barna, dhe si ka qenë furnizimi para dhe pas decentralizimit të barnave dhe kalimit të SHSKUK?

Imet Rrahmani: Edhe në fillim e theksova se buxheti për shëndetësi është i pamjaftueshëm dhe nuk mund të thuhet se shëndetësia është prioritet i Qeverisë, por brenda këtij buxheti do të mundohemi që të bëjmë më të mirën e mundshme.

Sa i përket trajtimit jashtë vendit jemi duke punuar që të identifikojmë se cilat shërbime mund t'i ofrojnë dhe me çfarë çmime, në mënyrë që të mund të zvogëlohet numri i atyre që kërkojnë shërim jashtë vendit.

Sa i përket kalimit të barnave të AFSH, kjo është kërkesë e donatorëve dhe ne duhet ta përmbushim, do ta përcjell këtë kërkesë te ju.

Fikrim Damka: Gjithashtu ministër, kam një kërkesë sa i përket një udhëzimi administrativ që ju e keni nxjerrë e që është udhëzimi administrativ 01/2015, e që është në kundërshtim me Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, te pjesa e licencimit me procedurë me të përshpejtuar, të barnave të vendeve Shengen?

Imet Rrahmani: Unë kam rekomandim nga zyra ligjore se udhëzimet janë në harmoni me Ligjin, por do ta vërtetoj prapë dhe do të ju përgjigjem, ndërsa nëse është në kundërshtim me Ligjin, do ta përmirësoj.

Hatim Baxhaku: Të gjithë pajtohem se buxheti për shëndetësinë është shumë i vogël, por mendoj se edhe ka keq menaxhim dhe me një menaxhim më të mirë mund të bëjmë më shumë me këtë buxhet të vogël që ka shëndetësia.

Gjithashtu mendoj se pa funksionalizimin e SISH-it nuk ka sukses, sepse në shëndetësi SISH është burim i të gjitha informatave, si për planifikime të buxhetit për ndarje të barnave, për planifikime të personalit dhe për funksionimin e përgjithshëm.

Imet Rrahmani: Sa i përket SISH-it, ne jemi duke punuar në funksionalizimin e tij.

Kemi ndërtuar sistemin kompjuterik (softare) të informacioneve si një hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i përgatitjes së të dhënave bazë. Kemi shtrirje të rrjetit në tri pilot- projektet që përfshin Prizrenin, Prishtinën dhe QKUK –në, ku po ecën mirë. Mendojmë se shumë shpejt SISH do të ketë shtrirje në tërë Kosovën.

Kjo punë parapërgatitore do të na orientojë drejt parashikimit dhe një ndarjeje sa më të saktë të buxhetit, si për numrin e kapaciteteve profesionale, specializimeve, kapaciteteve buxhetore për shtimin e personelit, blerjen e pajisjeve mjekësore, sasinë dhe llojet e ilaçeve për rimbursim etj.

Njomza Emini: Përsëritës pranin e ministrit dhe stafit të tij. Pajtohem me komentet dhe pyetjet e parashtruara nga kolegët deputetë megjithatë kam dy pyetje shtesë për ministrin: Çfarë është duke ndërmarrë ministria për t'u dalë në ndihmë me shërbime shëndetësore grupeve të marginalizuara dhe pyetja tjetër ka të bëjë me spitalin e Ferizajt, a është i mjaftueshëm buxheti i ndarë për ndërtimin e këtij spitali?

Imet Rrahmani: Ministria do të bëjë përpjekje që të gjitha grupeve të popullsisë, sidomos këtyre me nevoja të veçanta t'u ofrojë shërbime sa më të mira.

Sa i përket ndërtimit të spitalit të Ferizajt buxheti i ndarë nuk është i mjaftueshëm, por, ne, përmes donacioneve, do të bëjmë përpjekje që ky projekt të përfundojë brenda tri vjetëve.

Sadik Llullaku: Ju përsëritës dhe ju falënderoj për vizitën që keni realizuar ditë më parë në SHSKUK. Krijimi i bordit të SHSKUK- ut ka qenë një hap i mirë dhe i suksesshëm për reformën në shëndetësi dhe janë arritur përparime të mëdha. Janë duke u ofruar shumë shërbime të mira dhe edhe furnizimi me barna dhe material harxhues ka qenë në nivel më të kënaqshëm këtë vit, prandaj kërkojmë edhe përkrahjen tuaj, sidomos në shtimin e numrit të punëtorëve shëndetësorë.

Curr Gjocaj: Edhe unë si drejtor i SHSKUK-ut kërkoj përkrahjen tuaj në punën tonë dhe sidomos kërkoj përkrahjen tuaj sa i përket projektit të mamografit mobil. Ne kemi përgatitur projektin i cili ka një kosto prej 350 mijë euro. Deri tani mamografi mobil ka funksionuar me forcat vetjake të QKUK- së , por tani duhet të ketë një mbështetje të qëndrueshme pa marrë parasysh pjesë e cilit shërbim do të jetë ky mamograf.

Gjithashtu të ju them se këtë vit furnizimi me barna dhe material harxhues ka qenë më i mirë për shkak se janë menaxhuar nga SHSKUK.

Kryetarja: Ministër, sa i përket Raportit të progresit, për vitin 2015, nuk ka ndonjë përparim, të njëjtat probleme që janë shfaqur edhe në raportet e mëparshme. A keni ndonjë plan si do t'i qaseni të gjeturave të këtij raporti?

Imet Rrahmani: Që nga fillimi i mandatit kam për synim në përmbushjen e vërejtjeve të raportit të progresit. Janë ndërmarrë disa veprime shumë të rëndësishme dhe për detaje ia kaloj fjalën zyrtarit përgjegjës të ministrisë.

Mentor Sadiku: Me qëllim të adresimit të sfidave të Raportit të progresit Ministria e Shëndetësisë në Planin e Punës së Qeverisë për vitin 2016 dhe Planin Kombëtar për Adoptimin e Acquis ka paraparë aktivitete specifike për të cilat është siguruar buxhet nga donatorët dhe buxheti aktual i Ministrisë së Shëndetësisë.

Sfidë ndër më të rëndësishmet mbetet Sistemi i Informimit Shëndetësor, të finalizohet në mënyrë që të sigurojë mbledhjen e të dhënave relevante.

Për të adresuar këtë sfidë MSH ka propozuar këto aktivitete:

- Plotësimi i Hardware për 20% të rajonit pilot,
 - Trajnimi i 4500 punëtorëve shëndetësorë për përdorim të Softareve,
 - Funksionalizimi i SISH në institucionet në kuadër të pilot-projektit,
 - Realizimi i Projektit për partneritet publiko privat në SISH,
 - Sigurimi i shërbimeve ndërlidhëse (WAN),
 - Sigurimi i Softare dhe licencës për Grupimet sipas Diagnozave të DRG
- Gjithashtu parashihet fillimi i zbatimit të projektit KSV017.

Çështja tjetër e cila ceket në Raportin e Progresit- Megjithatë shpenzimet publike për shëndetësi mbesin më të ulëta në rajon, këto shkaqe vështirësojnë zbatimin dhe ekzekutimin e reformave dhe politikave të sektorit. Ligji për sigurime shëndetësore të zbatohet, Fondi i sigurimeve shëndetësore të themelohet. Pagesat nga xhepi për shërbime shëndetësore vazhdojnë të pengojnë qasjen në kujdes shëndetësor për të gjithë, përfshirë grupet vulnerable.

Për të adresuar këtë sfidë Ministria e Shëndetësisë ka propozuar këto aktivitete:

- Hartimi dhe miratimin e çmimore,
- Miratimi i Rregullores për menaxhim financiar,
- Miratimi i Rregullores për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm,
- Zhvillimi i dokumenteve për Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për studime përgatitore,
- Trajnimi i stafit të AFSH dhe strukturave relevante për funksionalizimin e Agjencisë të Financimit Shëndetësor (lidhur me sigurimet shëndetësore, DRG, komunikim, ngritje të qasjes në KPSH)
- Miratimi i Udhëzimit Administrativ për qytetarët dhe banorët e liruar nga bashkëfinancimi i shërbimeve shëndetësore.

Plani i Veprimit të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2014-2020 duhet të miratohet dhe Plani i Veprimit për sëmundje të rralla ka nevojë të zbatohet.

Për të adresuar këtë sfidë MSH ka propozuar këto aktivitete:

- Miratimin e Planit të Veprimit të SSSH 2015-2020.

Situata aktuale: nuk është paraparë ose propozuar ndonjë aktivitet për sëmundjet e rralla

Rekomandim: Ministria e Shëndetësisë ta rifunksionalizojë grupin punues të themeluar në vitin 2012 dhe të Hartoj planin e Veprimet për sëmundjet e rralla.

Vdekshmëria e fëmijëve mbetet më e larta në Evropë. Fondet e pamjaftueshme në sektorin e shëndetësisë ende janë pengesë për arritjen e nevojave bazike për shëndetin e nënës dhe fëmijës, shëndetësinë publike dhe ushqyeshmërinë që është risk për rritje normale të fëmijëve.

Për të adresuar këtë sfidë Ministria e Shëndetësisë ka propozuar këto aktivitete:

- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për shëndetin e nënës dhe fëmijës,
- Zhvillimi i aktiviteteve për skreningun e kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës,
- Zhvillimi i aktiviteteve të planifikimit familjar,
- Zhvillimi i trajnimeve për shëndet të nënës dhe fëmijës,
- Përkrahja për Programin për shëndetin e nënës dhe fëmijës (investime kapitale)
- Sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore (7 Spitale rajonale dhe 2 klinika të furnizuara me pajisjet për gjinekologji, obstetrikë dhe neonalogji),
- Miratimi i planit të ushqyeshmërisë.

Raportet për shëndetin e nënës dhe fëmijës të publikohen në Entin e Statistikave të Kosovës dhe si të tilla të raportohen në EUROSTAT, në mënyrë që të reflektohet saktësisht niveli i vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve.

Të rritet buxheti për këtë fushë, si dhe të riorientohet buxheti aktual nga kategoria investime kapitale në mallra e shërbime.

Infrastruktura e sëmundjeve ngjitëse dhe sistemi i raportimit ka nevojë të zhvillohet më tutje
Situata aktuale: Nuk ka aktivitet specifik për vitin 2016 që adreson këtë sfidë si mungesë e fondeve sipas IKSHPK.

Rekomandim: Të ndahet buxhet specifike për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse dhe të përcaktohen aktivitete specifike që adresojnë këtë sfidë, si dhe të zhvillohen kapacitetet për raportim.

Sa i përket produkteve të gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, Ligji për transplantimin e qelizave dhe indeve ka nevojë të zbatohet.

Për të adresuar këtë sfidë Ministria e Shëndetësisë ka propozuar këto aktivitete:

- Plotësim ndryshimi i ligjit për Transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe produktet e tij,
- Themelimi i Qendrës për transplantime të qelizave dhe indeve,
- Punësimi i pesë zyrtarëve,
- Caktimi dhe zgjedhja e koordinatorit nacional për transplantime,
- Trajnimi i stafit të Qendrës për transplantime të indeve dhe qelizave.

Ligji për transplantim të indeve dhe qelizave 2013/04-L-192 është miratuar në vitin 2013, është rekomanduar vazhdimisht në Raportet e progresit zbatimi i tij. Në Kuadër të Planit Kombëtar për Adoptim të Acquis aktivitet e propozuara janë ende të pasigurta si pasojë e mungesës së buxhetit sipas Qarkores së Tretë Buxhetore. Ligji për transplantim të organeve nuk është hartuar dhe miratuar ende.

Të sigurohet buxheti për këto aktivitete që ndërlidhen me zbatimin e ligjit për transplantim të indeve dhe qelizave. Të merret vendim për Hartimin dhe miratimin e Projektligjit për transplantim të organeve në programin legjislativ për vitin 2016 ose 2017.

Nuk është evidentuar progres, lidhur me të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, farmaceutik, shëndet mendor, parandalimin e abuzimit të drogave, skringut të kancerit dhe pabarazitë shëndetësore.

Për të adresuar këtë sfidë MSH ka propozuar këto aktivitete:

- Pilotimi i skrenigut në komunën e Prishtinës,
- Aktivitetet e Mamografit,
- Ndërtimi i Qendrës së sëmundjeve të varësisë (faza e parë),
- Miratimi i Strategjisë për promovim dhe edukim shëndetësor,
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e Rrjetit Shëndetësor të Evropës Juglindore.

Nuk ka marrëveshje specifike për bashkëpunim ndërkufitar lidhur me të drejtat e pacientëve, si dhe nuk ka aktivitete specifike që do të adresonin sfidën e mungesës së progresit në farmaceutikë dhe shëndet mendor, parandalimin e abuzimit me droga.

Anëtarësimi në Rrjetin Shëndetësor të Evropës Juglindore do të hapte rrugën për bashkëpunim më të mirë ndërkufitar. Sa i përket shëndetit mendor të orientohen resurset në dispozicion në rekomandimet e KE për adresimin e stigmes dhe risocializimit. Në farmaceutikë të vazhdohet me fuqizimin e kapaciteteve. Sa i përket skringut të kancerit të zbatohet plani kombëtar për kontrollin e kancerit dhe të ndahen mjete shtesë për këtë çështje. Nevojiten raporte të rregullta nga SHSKUK për aktivitetet që ofrohen në Onkologji dhe Radiologji. Të vazhdohet me programet e vaksinimit, dhe promovimit e edukimit për të adresuar pabarazitë me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas.

Këto janë disa nga hapat dhe aktivitet që Ministria e Shëndetësisë i ka ndërmarrë dhe do t'i vazhdojë edhe në të ardhmen për përmbushjen e sfidave që dalin nga Raporti i Progresit.

Kryetarja: Gjithashtu pata një pyetje sa i përket funksionimit të shërbimeve shëndetësore në komunat me shumicë serbe, janë 520 punëtor shëndetësor , a janë të licencuar spitalet dhe stafi shëndetësor nga Ministria e shëndetësisë, ashtu si parashihet me Ligjin e shëndetësisë. Kërkoj nga ju ministër që ta zbatoni ligjin e shëndetësisë dhe ata të kenë licenca të Kosovës.

Imet Rrahmani: Janë bërë hapa të rëndësishëm në integrimin e shërbimit shëndetësor të veriut, mirëpo sa i përket licencimit , nuk e di , nuk e kam të saktë informacionin, do t'ju njoftoj me shkrim lidhur me këtë çështje.

Kryetarja: Ju falënderojë për pjesëmarrje dhe për përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme.

Kryetarja tha se nëse nuk keni asgjë te kjo pikë, e shpallim të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA